




REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT / ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. DPK	Nr Prot. 03-02/3640
Dep. 02	Prot. No. 03-02/3640
Nr. f. 02	Data 03-11-2017
Nr. pages 02	03-11-2017



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 03.11.2017, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-2391/17, për zyrtarin e lartë z. Naser Sahiti, Prorektor në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të Interesit dhe papajtueshmërisë në ushtrim të funksionit publik .

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-03-02-2391/17, që për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Naser Sahiti, Prorektor në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina"

Gjatë zhvillimit të procedurës për identifikimin e rasteve të konfliktit të interesit, është vërejtur se zyrtari i lartë z. Naser Sahiti, Prorektor në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" figuron si person i autorizuar në një biznese private e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L- 051, kjo situatë paraqet konflikt të interesit, dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet që posedon Agjencia.

Pas kësaj shkrese z. Naser Sahiti, ka ardhur në takim në zyrat e AKK-së dhe nga zyrtarët e AKK-së, është njoftuar me faktet që posedon Agjencia lidhur me rastin e iniciuar.

z. Sahiti, është pajtuar me gjendjen, por është arsyetuar se nuk ka qenë i informuar se kjo situatë është në kundërshtim me ligjin në fuqi, por është zotuar se brenda afatit ligjor do të bëjë ndryshimet dhe do të veprojë sipas ligjit në fuqi për ta parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit.

Pas kësaj shkrese, nga z. Naser Sahiti, Prorektor në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" kemi pranuar një dokument të lëshuar nga ARBK-ja, ku shihet se z. Sahiti, nuk figuron me si person i autorizuar në biznesin me emër N.SH "ERES"

Vlerësojmë se pas veprimeve të ndërmarra nga z. Naser Sahiti, Prorektor në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" duke u larguar nga funksioni si person i autorizuar në biznesin privatë janë krijuar rrethana të reja dhe është shmangur gjendjen e mundshme e konfliktit të interesit dhe papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë, dhe u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja,

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

